



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1465/1 prot.

Tiranë, më 09. 11. 2020

**V E N D I M**

**Nr. 161, datë 09. 11. 2020**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa nr. 124, datë 27.10.2020, e shtetasit A. H., kundër Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në vijim MASR) me pretendim diskriminimin për shkak të *“përkatësisë në një grup të veçantë”*<sup>1</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, në mes të tjerash, subjekti ankues deklaroi se ka fituar titullin “Profesor i Asociuar”, vitin 2000, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe për 10 vite rradhazi ka punuar në vijim për të fituar titullin “Profesor”, sipas kriterëve dhe kërkesave të parashikuara në Vendimin nr. 467, datë 18.07.2007, e Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin, shkencor e pedagogjik, të personelit akademik”* (i ndryshuar).

Për sa më sipër, ankuesi sqaron se ka depozituar dosjen e tij pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, në shtator të vitit 2014, e cila është dërguar për shqyrtim nga Këshilli i Profesorëve të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit me nr. 168 prot., datë 20.06.2016, ku është e arkivuar edhe sot, sepse nuk u shqyrtua nga KP gjatë muajve Korrik, Gusht dhe në Shtator u ndërpre puna e komisionit të titujve akademike në MASR, në pritje të daljes së akteve nënligjore të ligjit 80/2015 të cilat u finalizuan në Universitetin Politeknik të Tiranës në dhjetor 2019.

<sup>1</sup> Grupi i personave që i kanë dorëzuar dosjet që në vitin 2016, për dhënien e titujve akademik brenda afatit dhe nuk janë shqyrtuar në atë kohë nga Këshilli i Profesorëve,

Pretendimi i tij për diskriminim qëndron edhe ndaj parashikimit të pikës 7, të Dispozitave Kalimtare, të Vendimit nr.112, datë 23.02.2018, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor””,* ku parashikohet: *“Kandidatët, të cilët kanë filluar procedurën për marrjen e titujve akademikë dhe kanë kaluar fazën e miratimit nga Këshilli i Profesorëve, e mbyllin procedurën për marrjen e titullit akademik, sipas kriterëve të legjislacionit në fuqi, në momentin e dorëzimit të dosjes në Këshillin e Profesorëve. Këta kandidatë ndjekin procedurat e përcaktuara në këtë vendim, për fazën përfundimtare në Komisionin për Promovimin e Personelit Akademik”.* Për sa më sipër, ankuesi shprehet se ai e ka depozituar dosjen pranë Këshillit të Profesorëve dhe ky i fundit nuk e ka marrë në shqyrtim. Në këtë kontekst, ai pretendon se diskriminohet nga parashikimi i dispozitës së mësipërme.

Në këtë kuptim, ankuesi pretendon se personat që i kanë dorëzuar dosjet që në vitin 2016, për dhënien e titujve akademik brenda afatit dhe nuk janë shqyrtuar në atë kohë nga Këshilli i Profesorëve, nuk janë përfshirë në VKM-në nr. 118, datë 23.02.2018 *“Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademik ‘Profesor i asociuar’ dhe ‘Profesor’”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ti rekomadojë MASR-së për një ndryshim në pikën 7 të VKM-së nr. 118, datë 23.02.2018, ku duhet të shtohet që edhe dosjet e dorëzuara në protokoll para muajit gusht 2016 ta përfundojnë procedurën sipas kriterëve të akteve ligjore që kanë qënë në fuqi (VKM nr. 467, datë 18.07.2007).

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ankuesi dhe formularit të ankesës, situata diskriminuese ndaj tij përkon me momentin kur ankuesi ka dorëzuar për herë të fundit dosjen pranë Këshillit të Profesorëve, më datë **20.06.2016**. Në vijim, sipas ankuesit, ai i është drejtuar sërish Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, më datë 12.10.2020 dhe është informuar se nuk mund të nisët procedura e vlerësimit të dosjes së tij pasi ajo nuk është shqyrtuar nga Këshilli i Profesorëve në vitin 2016.

Gjithashtu, rezulton se ankuesi me të njëjtat parashtrime dhe pretendime për diskriminim ka paraqitur ankesën Nr. 71, datë 20.06.2019 pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të cilën është marrë vendimi Nr. 89, datë 08.07.2019, për mospranimin e saj, pasi është depozituar tej afateve ligjore, pranë KMD-së.

Në analizë të informacionit të sipërcituar, pavarësisht kërkesës drejtuar Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, më datë 12.10.2020 dhe përgjigjes së marrë prej tyre, nuk rezulton se ankesa ka të dhëna të reja për të cilat Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mund të fillojë procedurën e shqyrtimit të saj.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/c të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “***Ankesa nuk pranohet nëse e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një anese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja;***”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Nga shqyrtimi i kësaj ankese dhe bazuar në nenin 33, pika 4/c të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së A. H., për shkak se për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)